



25 - 03 - 2009

[Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ/ OPŠTINSKI SUD U UROŠEVCU/ MUNICIPAL  
COURT IN FERIZAJ

P. nr. 147/06.

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari Bashkim Hyseni, me procesëmbajtësen, Hajrie Arifi, sekretare juridike në këtë gjykatë, në çështjen penale kundër të pandehurit, [REDACTED] nga Ferizaj, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.2. të KPK-së, sipas propozim akuzës së PPK-së në Ferizaj Pp nr.279/06. të dt. 29.03.2006, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt. 28 janar 2009, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit publik, Rasim Maloku, të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuji [REDACTED] nga Ferizaj m. [REDACTED] pn, i lindur me datë [REDACTED] në fsh. [REDACTED], nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] i pa martuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfér ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 26.02.2006 rrëth orës 13.20 në fshatin Jezerc në lokacionin e quajtur "Rrasa e thatë" derisa i dëmtuari [REDACTED] ishte duke lëvzur me qerre me kuaj në drejtim të Ferizajt, ka takuar të pandehurin [REDACTED] dhe pasi edhe me parë kishin pasur problem në mes vete, së pari ishin fjalosur e më pas edhe janë syer ku me atë rast i pandehuri me sopat e godet në pjesën e mbrapme të kokës, ku të dëmtuarit i kishte shkaktuar lëndim të lehtë trupor dhe atë plagë shtypëse shqyese të kokës në pjesën e pasme, plagë shtypëse e shpinës të cilët kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit dhe nuk kanë rrezikuar jetën e tij.

-me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen 153 par.2.të KPK-së.

Në bazë të dispozitës së sipërcituar si dhe dispozitat nga nen 3, 34, 41, 42, 43, 44, 64 të KPK-së si dhe nenit 391 të KPPK-së : i

## SHQIPTON

### DËNIM ME KUSHT

Vërtetohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5/pesë/ muaj, i cili dënim nuk do të e kzekutohet, nëse i pandehuri në përiudhën kohore për 1/një/ viti nga ditë e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

I dëmtuari, [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], komuna e Ferizajt, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumësn prej 25,55 €, si dhe paushallin gjyqësor shumën prej 25 € në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit.

### Arsyimi

PPK në Ferizaj me propozim akuzën PP. nr. 279/06 dt. 29.03.06 e ka ngarkuar të pandehurin, [REDACTED] nga Ferizaj për vepër penale lëndim i lehtë trupor nga nen. 153 par.2. të KPK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor me dt. 28.01.2009 në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori publik [REDACTED] mbeti në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale duke i propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj.

I dëmtuari, [REDACTED] nuk ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor nga fletëkthesa e kësaj gjykate potencoitet se gjendet në botën e jashtme.

I pandehuri, [REDACTED] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar: se e pranon fajsinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, është penduar për veprën e kryer dhe ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tillë, duke propozuar që ndaj tij të shqiptohet një dënim sa më i butë.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga nen. 315 par.1 të KPPK-së, meqë i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, një pranim i tillë është

bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat e kësaj çështje penale, andaj shqyrtimi gjyqësor konformë nenit 359 par.5 të KPPK-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Analizuar nga aspekti juridik në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha tiparet subjektive dhe objektive të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par. 2 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 64 të KPK-së, si rrethana lehtësuese mori pranimin e fajsisë, gjendjen e varfër ekonomike dhe moshën relativist të re, në mungesë të rrethanave veçanarishtë rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrëzikshmérinë konkrete të veprës penale, andaj në kuptim të gjitha këtyre rrethanave i caktoi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5/pesë/ muaj, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën kohore prej 1/një/ viti nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është adekuat dhe proporcional në raport me peshën e veprës, shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, njëkohësisht me të mund të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimive dhe qëllimi i dënimit me kusht edhe përmes shpalljes së dënimit dhe pa ekzekutimin e tij.


Konformë nenit 112 par.2 të KPPK-së i dëmtuari [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konformë nenit 99 dhe 102 të KPPK-së obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumës prej 25,55 €, si dhe paushallin gjyqësor shumën prej 25 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ,  
P.nr. 147/06. të dt. 28.janar.2009**

Sek juridike,  
Hajrije Arifi

**Gjyktari,**  
Bashkim Hyseni



**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në a fat prej 8 /tetë/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi gjykatës së Qarkut në Prishtinë npërmjet kësaj gjykate.